



Data: 11.02.2020

Ref.: 145/20D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 79-të të mbajtur më 16 dhe 17.01.2020, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit Heimerer për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2020 – 30 shtator 2023:
 - Pedagogji Profesionale, në Shëndetësi/ Fusha Profesionale e Infermierisë, BSc, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik
- II. Nuk riakreditohet programi i studimit i Kolegjit Heimerer:
 - Shkenca Shëndetësore për Profile Diagnostike/ Teknik Laboratori, BSc, 180 ECTS
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Heimerer, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit. Vizita është realizuar me 18.10.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Melita Kovacevic, Mladen Krajacic dhe Helvi Kyngas.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 16 dhe 17.01.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Heimerer dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë

realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin e programit Pedagogji Profesionale, në Shëndetësi/ Fusha Profesionale e Infermierisë, BSc, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se ky program përmbush kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, dhe rekomandon riakreditimin e programit.

Sa i përket programit Shkenca Shëndetësore për Profile Diagnostike, BSc, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se ky program përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit. Nga gjithsejtë shtatë (7) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se programi në fjalë plotëson substancialisht tre (3) (Misioni, Objektivat dhe Administrata; Studentët; Hulumtimi) ndërsa pjesërisht katër (4) (Menaxhimi i cilësisë; Stafit Akademik; Përmbajtja e procesit arsimor; Infrastruktura dhe burimet).

Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se ka mungesë të konsistencës si dhe mungojnë detaje të konsiderueshme lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me organizimin dhe ofrimin e programit. Pos kësaj një pjesë e dokumenteve të dorëzuara janë të paqarta e disa tjera janë në gjuhën shqipe.

Kapitulli i standardeve që ka të bëjë me stafin akademik gjithashtu është konstatuar nga ekspertët ndërkombëtar si pjesërisht i përmbushur. Sipas ekipit të ekspertëve, programi i studimit në fjalë prezantohet si program interdisiplinar, mirëpo stafi i prezantuar për të mbajtur lëndët në kuadër të këtij programi nuk reflekton qasjen interdisiplinare të tij. Po ashtu planet për zhvillim të stafit të ofruara në RVV nuk arsyetojnë tendencën për ndryshime të nevojshme të strukturës së stafit.

Përmbajtja e programit është prezantuar me dokumente të shkruara dobët. Në raportin e vlerësimit ekspertët kanë shënuar një varg shembujsh për të ilustruar këtë fakt, duke përfshirë një kurs i cili ka një ngarkesë prej 60 orësh dhe nuk ka titull (emër) si dhe është i përshkruar me vetëm një fjali. Sipas ekipit të ekspertëve, cilësia e dobët e syllabusëve komprometojnë jo vetëm anëtarët e stafit mësimdhënës por edhe përmbajtjen e programit si tërësi. Për më tepër, ekspertët vlerësojnë se të gjitha pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga vlerësimi i vitit 2015 kanë mbetur të pa adresuara.

Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me infrastrukturën dhe resurset, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se infrastruktura dhe resurset për ushtrime praktike reflektojnë kapacitetin e Kolegjit si IAL që është e pajisur mirë për programe të Infermierisë dhe ndoshta edhe për programe tjera. Mirëpo, kolegji posedon vetëm një laborator me mikroskopë, gjë që është shumë larg pritjeve për realizimin e programit Teknik Laboratori. Programi i studimit nuk mund të mbështetet vetëm në laboratorë të jashtme, përndryshe edhe ato laboratorë do të duhej t'i nënshtroheshin procedurave të akreditimit. Në planin financiar ekspertët kanë vërejtur se nuk janë planifikuar shpenzime për materiale shpenzuese si dhe për servisim e mirëmbajtje të instrumenteve. Sa i përket burimeve dhe infrastrukturës, edhe në bibliotekë është vërejtur se kolegji nuk qëndron aspak keq sa i përket titujve nga fusha e infermierisë apo fizioterapisë, por mungojnë në mënyrë të konsiderueshme titujt lidhur me programin e studimit Teknik Laboratori.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Heimerer;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë